<p>Bashkia Shkodër është një nga bashkitë më të rëndësishme dhe të pasura në Shqipëri, jo vetëm për historinë dhe kulturën e saj, por edhe për burimet natyrore dhe traditat e pasura artizanale. Pavarësisht se shumë elemente të territorit (trashëgimia kulturore dhe historike, arkitektura, sporti, produktet vendase, etj), janë me vlerë dhe me një traditë të gjatë, ato shpesh janë të ngatërruara me rajone të ndryshme të Shqipërisë, dhe shpesh vizitorët/konsumatorët e huaj nuk e dinë se çfarë i bën ata të veçantë. Produktet apo shërbimet shpesh nuk janë të mbështetura nga një identitet i qartë marke, duke u bërë të vështira për t'u dalluar dhe për t'u promovuar në tregjet më të gjera, si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar. Për këtë është thelbësore një strategji e mirëfilltë brandimi, i njohur ndryshe si "Brandimi i territorit të Bashkise Shkodër". Brandimi ka për qëllim krijimin e një identiteti të fortë dhe të qëndrueshëm për Bashkinë Shkodër, duke promovuar vlerat e jashtëzakonshme të trashëgimisë kulturore, historike, arkitekturore dhe aspekte të tjera të qytetit. Nëpërmjet këtij procesi synojmë ndërtimin e një marke që pasqyron histori të pasur, tradita dhe elemente unike që i japin Shkodrës një pozicion të veçantë si një destinacion për vizitorët dhe si një qendër me mundësi për zhvillim ekonomik dhe kulturor.</p> <p>Ky projekt ka një rëndësi të vecante ekonomike dhe kulturore, pasi jo vetëm që do të evidentoje vlerat e këtij territori, por gjithashtu do të mundësojë promovimin e produkteve vendore, duke lidhur ato ngushtësisht me historinë dhe traditat e pasura. Kjo strategji do të rrisë ndërgjegjësimin e konsumatorëve, duke i bërë ata të vlerësojnë origjinalitetin dhe cilësinë e produkteve lokale, siç janë artizanatet, ushqimet tradicionale, dhe produkte të tjera turistike.</p> <p>Për më tepër, ndihma e drejtuar ndaj sipërmarrësve dhe prodhuesve lokale do të lejojë zhvillimin e kapaciteteve të tyre dhe integrimin në një zinxhir global tregu, duke nxitur zhvillimin ekonomik dhe krijimin e mundësive për punësim.</p>								
ii. Synimi i projektit								
Krijimi i një identiteti tërheqës dhe autentik për Shkodrën, që të pasqyrojë pasuritë e trashëgimisë së tij dhe t'i shërbejë si një motor për zhvillimin ekonomik, kulturore dhe social në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar.								
iii. Aktivitetet kryesore të projektit								
<ol style="list-style-type: none"> 1. Krijimi i një baze të dhënash për katalogimin e shërbimeve/produkteve 2. Hartimi i një udhëzuesi për krijimin e shërbimeve/ produkteve të markuara 3. Hartimi i një strategjie marketingu 4. Takime konsultative dhe informuese me bizneset 								
b) Rezultatet që prisni								
<ul style="list-style-type: none"> - Njohja kombëtare dhe ndërkombëtare e markës - Rritja e shitjeve dhe eksportit - Mbështetje për sipërmarrjet - Zhvillimi i turizmit dhe promovimi i produkteve lokale 								
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt				
Bashkia Shkodër Dhoma e Tregtisë Grupet e interesit				Bashkia Shkodër, Donatorë, Programe të BE-së.				
e) Shpenzimet e llogaritura								
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025			Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
				Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Brandimi i produkteve të territorit të Bashkisë Shkodër.		1,300					1,300
Shuma			1,300					1,300
f) Periudha e zbatimit 2025				g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtorja e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër				

Nr. 4	P.AC141.Q1.O2.A1. Bashkëpunimi rajonal dhe koordinimi i ndihmës së huaj	Programi AC141: Mbështetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural
a) Përshkrim i shkurtër i projektit:		
i. Situata		
<p>Bashkëpunimi rajonal dhe koordinimi i ndihmës së huaj përfshin krijimin e mundësive për të forcuar marrëdhëniet dhe bashkëpunimin me autoritetet rajonale dhe ndërkombëtare. Ky proces ka si qëllim përmirësimin e koordinimit të fondeve dhe ndihmës së huaj për të optimizuar përdorimin e burimeve dhe për të siguruar që investimet e huaja të jenë në përputhje me prioritetet zhvillimore të Bashkisë Shkodër. Pjesë e këtij bashkëpunimi është gjithashtu identifikimi i mundësive për të rritur mbështetje për projekte të përbashkëta rajonale dhe ndërkombëtare, që ndihmojnë në zhvillimin ekonomik, përmirësimin e infrastrukturës dhe forcimin e kapaciteteve të administratës vendore.</p> <p>Duke e konsideruar integrimin në BE si perspektivën më të mirë të zhvillimit dhe si një sfidë e përbashkët e vendeve të rajonit, Bashkia Shkodër ka promovuar iniciativën e bashkëpunimit të zgjeruar rajonal, duke lidhur marrëveshje bashkëpunimi me disa qytete në rajon, me lidhje të hershme ndër shekuj dhe me vlera që na bashkojnë në fushën ekonomike, kulturore e njerëzore. Konsolidimi i këtij bashkëpunimi është i rëndësishëm së veçantë jo vetëm për gjenerimin e ideve për të intensifikuar bashkëpunimin rajonal por edhe në theqjen e fondeve të Bashkimit Europian, në kuadër të programeve të ndryshme ndërkufitare. Një rajon i cili zhvillon projekte të përbashkëta në funksion të një zhvillimi ekonomik të balancuar, gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm, u shërben jo vetëm interesave vendore por përbën gjithashtu një kontribut të rëndësishëm në procesin e integritimit evropian.</p> <p>Pjesë e kësaj fishe do të jetë edhe mbulimi i shpenzimeve për projektet e shpallura fituese në kuadër të programeve kombëtare, duke siguruar alokimin e burimeve të nevojshme për implementimin e suksesshëm të këtyre projekteve. Ky proces do të mundësojë financimin e aktiviteteve që kanë për qëllim përmirësimin e infrastrukturës, ofrimin e shërbimeve, dhe rritjen e kapaciteteve në nivel vendor, duke mbështetur gjithashtu zhvillimin ekonomik. Mbulimi i shpenzimeve do të përfshijë ndarjen e fondeve për projektet që janë shpallur fituese, duke garantuar kështu një menaxhim të qëndrueshëm të buxhetit dhe një përdorim efikas të resurseve. Kjo do të sigurojë që projektet të realizohen brenda afateve dhe me cilësi të lartë, duke kontribuar në rritjen e standardeve të jetesës për qytetarët.</p> <p>Gjithashtu Bashkia Shkodër do të intensifikojë përpjekjet e saj në drejtim të anëtarësimit në shoqata ndërkombëtare me qëllim zhvillimin ekonomik të vendit, promovimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore si dhe mbrojtjen e mjedisit në bashkëpunim me vende të tjera të Bashkimit Evropian dhe jo vetëm. Natyrisht anëtarësimi në shoqata ndërkombëtare sjell të drejta dhe detyrime për vendet anëtarë, brenda kufijve të përcaktuara në statut. Një ndër këto detyrime është edhe shlyerja e kuotës vjetore të anëtarësisë. Prandaj për çdo anëtarësim të mundshëm në shoqata ndërkombëtare, Bashkia Shkodër merr përsipër përbushjen e detyrimeve financiare (shlyerjen e kuotës vjetore të anëtarësisë) për kohën gjatë së cilës është pjesë e shoqatës.</p> <p>Sa mësipër, Bashkia Shkodër shpreh angazhimin e saj për marrjen pjesë në Programet e BE-së. Gjatë viteve të fundit numri i projekteve të financuara në kuadër të thirrjeve të IPA dhe programe të tjera të financuara nga BE është i konsiderueshëm. Përmendim këtu Programi Adrion Interreg, Horizon Europe, Europe Aid Call for Proposal, IPA Crossborder Shqipëri — Mali i Zi, Programi MED, etj. Tashmë Bashkia Shkodër është anëtarësuar edhe në shoqata si FAIC dhe Rjeti i Qyteteve Ballkanike B40 Balkan Cities Network:</p> <p>Në të dyja rastet lind e nevojshme parashikimi i një fondi për anëtarësimin në shoqata ndërkombëtare si dhe mbulimin e shpenzimeve në zërat e buxhetit vjetor dhe afatmesëm.</p>		
ii. Synimi i projektit		
Të parashikojë fondin për anëtarësimin në shoqata ndërkombëtare si dhe të parashikojë fondin për mbulimin e shpenzimeve në kuadër të bashkëpunimeve në Programet e Bashkimit Europian për periudhën 2025 — 2027.		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
<ol style="list-style-type: none"> 1. Bashkia Shkodër do të përbushë detyrimet financiare që rrjedhin nga anëtarësimi në shoqata ndërkombëtare. 2. Bashkia Shkodër do të përbushë detyrimet financiare që rrjedhin nga marrëveshjet e granteve të nënshkuara nga Bashkia Shkodër në përputhje me legjislacionin në fuqi. 		
b) Rezultatet që prisni		
<ul style="list-style-type: none"> – Ngritje e kapaciteteve institucionale; – Rritja e numrit të projekteve të financuara nga programe të ndryshme; – Përfshirje e Bashkisë Shkodër në shoqata ndërkombëtare; – Rritje e transparencës me publikun. 		
c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen)	d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht, etj.)	

Bashkia Shkodër Delegacioni i Bashkimit Europian			Bashkia Shkodër Programet e BE-së Shoqata ndërkombëtare Donator të tjerë					
e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii))								
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025			Totali (mijë lekë)	Nga kjo				
				Paga	Sigurime	Operative	Transfe rime	Kapita le
A.1	Vlerë anëtarësimi të Bashkisë Shkodër në shoqata ndërkombëtare.		200				200	
A.2	Shpenzime të tjera për projektet e financuara nga BE dhe organizata të tjera		300			300		
A.3	Mbulimi i shpenzimeve të programuar për udhetime		300			300		
Shuma			800			600	200	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026			Totali (mijë lekë)	Nga kjo				
				Paga	Sigurime	Operative	Transfe rime	Kapita le
A.1	Vlerë anëtarësimi të Bashkisë Shkodër në shoqata ndërkombëtare.		200				200	
A.2	Shpenzime të tjera për projektet e financuara nga BE dhe organizata të tjera		300			300		
A.3	Mbulimi i shpenzimeve të programuar për udhetime		300			300		
Shuma			800			600	200	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027			Totali (mijë lekë)	Nga kjo				
				Paga	Sigurime	Operative	Transfe rime	Kapita le
A.1	Vlerë anëtarësimi të Bashkisë Shkodër në shoqata ndërkombëtare.		200				200	
A.2	Shpenzime të tjera për projektet e financuara nga BE dhe organizata të tjera		300			300		
A.3	Mbulimi i shpenzimeve të programuar për udhetime		300			300		
Shuma			800			600	200	
f) Periudha e zbatimit 2025,2026,2027				g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:				
				Drejtorja e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit				
				Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër				

Nr. 5	P.AC141.Q1.O2.A2. Bashkia për BE-në	Programi AC141: Mbështetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural				
a) Përshkrim i shkurtër i projektit:						
i. Situata						
<p>Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 450, datë 26.7.2018 "Për bashkërendimin dhe koordinimin e procesit të integritimit evropian, ndërmjet qeverisjes qendrore dhe njërive të vetëqeverisjes vendore", janë krijuar strukturat e Integritimit Evropian në 61 Bashkitë e Shqipërisë. Në këtë kuadër është krijuar struktura edhe në Bashkinë Shkodër, misioni i secilës është të mbështesë dhe koordinojë strukturat e bashkisë, në realizimin e reformave për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i Integritimit Evropian. Të sigurojë programimin dhe zbatimin me efikasitet të gjithë financimeve në kuadër të programeve të BE-së dhe donatorëve të tjerë, nga të cilat përfiton bashkia.</p> <p>Sa më sipër ky sektor do të luajë një rol të rëndësishëm në promovimin e parimeve të BE-së në nivel vendor duke organizuar aktivitete të ndryshme informuese dhe promovuese mbi politikat, programet dhe projektet e Bashkimit Evropian. Për këtë qëllim çdo muaj sektori i integritimit evropian Shkodër organizon minimalisht 2 aktivitete në muaj sipas tematikave të caktuara dhe sipas ditëve evropiane dhe ndërkombëtare. Këto aktivitete organizohen në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile, shkollat 9 vjeçare, të mesme të përgjithshme dhe profesionale, Universitetin e Shkodrës Luigj Gurakuqi, etj. Numri i pjesëmarrësve në këto aktivitete varion nga 20 pjesëmarrës, në rastin e takimeve me fokus grupet deri në 400 pjesëmarrës në rastin e aktiviteteve të mëdha promovuese. Në këto aktivitete do të përfshihen edhe sesionet informuese në kuadër të hapjes së negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Hapja e negociatave është një proces i rëndësishëm për integrimin e vendit në BE e cila përfshin zhvillimin ekonomik, institucional dhe social. Për të siguruar një proces të suksesshëm, është e nevojshme të angazhohen të gjithë aktorët, përfshirë edhe qeverisjen vendore.</p>						
ii. Synimi i projektit						
<ol style="list-style-type: none"> 1. Të promovojë parimet e Bashkimit Evropian në nivel vendor; 2. Të krijojë një ndërveprim efektiv midis BE-së, qeverisjes qendrore dhe zyrës së çështjeve të BE -së në secilën Bashki në Shqipëri. 3. Të rrisë njohuritë për IPA-n si dhe fondet e tjera kryesore të BE-së të disponueshme për bashkitë dhe qytetarët Shqiptarë. 						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<p>Bashkia Shkodër do të organizojë fushata informuese mbi politikat, programet dhe projektet e Bashkimit Evropian, nëpërmjet zyrës së çështjeve të BE-së Shkodër dhe kanaleve të ndryshme promovuese.</p>						
b) Rezultatet që prisni						
<ul style="list-style-type: none"> - Ngritje e kapaciteteve institucionale; - Përmirësim i shërbimeve me standarde evropiane; - Rritje e transparencës me publikun; - Njohja e politikave dhe programeve të BE-së. 						
c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen)				d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht, etj.)		
Bashkia Shkodër Delegacioni i Bashkimit Evropian				Bashkia Shkodër Programet e BE-së Donator të tjerë		
e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii))						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025			Totali (mijë lekë)	Nga kjo:		
A.1	Organizim i aktiviteteve promovuese të lidhura me festat ndërkombëtare.	400	Paga	Sigurime	Operative	Transferime Kapitale
Shuma		400			400	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026			Totali (mijë lekë)	Nga kjo:		
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime Kapitale

A.1	Organizim i aktiviteteve promovuese të lidhura me festat ndërkombëtare.	400			400		
	Shuma	400			400		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Organizim i aktiviteteve promovuese të lidhura me festat ndërkombëtare.	400			400		
	Shuma	400			400		
f) Periudha e zbatimit 2025,2026,2027		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër					

Nr. 6	P.AC141.Q1.O2.A3. Diaspora dhe migracioni	Programi AC141: Mbështetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural				
a) Përshkrim i shkurtër i projektit:						
i. Situata						
<p>Diaspora dhe migracioni janë elemente të rëndësishme për zhvillimin social, ekonomik dhe kulturor të Bashkisë Shkodër. Shkodra ka një traditë të thellë migrimi dhe një prani të konsiderueshme të diasporës, e cila ka luajtur dhe vazhdon të luajë një rol kyç në avancimin e rajonit, duke kontribuar përmes remitancave, investimeve dhe shkëmbimit të njohurive dhe kulturës. Kjo lidhje me diasporën ndihmon në rritjen e mundësive për zhvillim dhe forcimin e lidhjeve mes qytetit dhe shqiptarëve jashtë vendit.</p> <p>Me funksionet e shtuara të pushtetit vendor në lidhje me çështjet e migracionit dhe diasporës, Bashkisë Shkodër i lind detyrimi dhe përgjegjësia që nga njëra anë të kontribuojë në ri-integrimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social të emigrantëve të kthyer duke respektuar, mbrojtur dhe përmbytur të drejtat e tyre njerëzore, dhe në të njëjtën kohë të krijojë kushte të favorshme, të cilat i mundësojnë diasporës, përmes kapaciteteve të tyre intelektuale, njerëzore, ekonomike dhe sociale, të pasurojë shoqërinë tonë, për të kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm në nivel lokal.</p> <p>Në këtë kuadër lind nevoja e informimit të publikut mbi kompetencat, ndihmën dhe mundësitë që Bashkia Shkodër ofron për këto dy kategori: nga njëra anë emigrantet e kthyer, të cilët duan të rikthehen, të jetojnë dhe të kontribuojnë në vendin e tyre dhe nga ana tjetër diaspora, e cila ruan dhe kërkon të çojë përpara lidhjen shpirtërore me vendin e origjinës duke kontribuar në jetën kulturore, sociale dhe ekonomike të tij. Gjithashtu, qëllimi tjetër i kësaj fise është të organizojë sesione informuese dhe video promovionale në lidhje me migracionin e rregullt dhe hapat që duhet të ndiqen.</p>						
ii. Synimi i projektit						
Të rrisë njohuritë mbi politikat e Bashkisë Shkodër në lidhje me migracionin e rregullt, migracionin e kthimit dhe diasporën.						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<p>Bashkia Shkodër do të sigurojë informimin e publikut dhe veçanërisht grupet e tjera të interesit për politikat e saj në lidhje me çështjet e migracionit dhe diasporës.</p> <p>Sesione informuese për migrimin e rregullt.</p> <p>Promovimi i modeleve të suksesit të kthyer nga Diaspora.</p> <p>Promovimi i profesionistëve të fushave të ndryshme të suksesshem në Diasporë.</p>						
b) Rezultatet që prisni						
<ul style="list-style-type: none"> - Informimi i publikut në lidhje me politikat vendore për çështjet e migracionit dhe diasporës; - Ngritje e kapaciteteve institucionale; - Rritje e transparencës me publikun. 						
c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen)			d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht, etj.)			
Bashkia Shkodër Delegacioni i Bashkimit Europian Agjensia për diasporën			Bashkia Shkodër Programet e BE-së Shoqata dhe organizata për migracionin dhe diasporën Organizata ndëtkombëtare.			
e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii))						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
A.1	Organizim i aktiviteteve informuese/ngjarjeve për publikun dhe grupet e tjera të interesit në lidhje me migracionin dhe diasporën.	500	Paga	Sigurime	Operative	Transferime Kapitale
Shuma		500			500	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime Kapitale

A.1	Organizim i aktiviteteve informuese/ngjarjeve për publikun dhe grupet e tjera të interesit në lidhje me migracionin dhe diasporën.	500			500		
	Shuma	500			500		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Organizim i aktiviteteve informuese/ngjarjeve për publikun dhe grupet e tjera të interesit në lidhje me migracionin dhe diasporën.	500			500		
	Shuma	500			500		
f) Periudha e zbatimit 2025,2026,2027		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër					

Nr.7	P.AC141.Q1.O3.A1 Bashkëpunimi me Zonën e Përmirësimit të Biznesit në Shkodër.	Programi AC141: Mbështetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural					
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit							
i. Situata							
<p>Bashkia Shkodër në bashkëpunim me AADF (Fondacioni i Zhvillimit Shqiptaro–Amerikan) vazhdon në mënyrë të suksesshme projektin e mbështetjes së përmirësimit të biznesit përgjatë rrugëve “13 Dhjetori”, “28 Nëntori” dhe “Kolë Idromeno”. Në zbatimin e programit të bashkëpunimit me qëllim zhvillimin dhe përmirësimin e klimës së biznesit në zonë, Shoqata e bizneseve ka ofruar shërbime publike shtesë, ka zhvilluar një sërë aktivitetesh kulturore, argëtuese, disa prej të cilave edhe në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër. Ka ofruar konsulencë profesionale për bizneset e zonës me qëllim zhvillimin e qëndrueshëm dhe përmirësimin e klimës së biznesit. Nga ana tjetër, është përmirësuar ndjeshëm cilësia e shërbimeve të ofruara nga bizneset në këtë zonë. Në këtë kuadër vazhdimi i bashkëpunimit me shoqatën e bizneseve në shërbim të përmirësimit të zonave të biznesit do të realizohet me anë të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe shoqatës egzistuese të bizneseve përgjatë rrugëve “13 Dhjetori”, “28 Nëntori” dhe “Kolë Idromeno”. Hapsira publike do të trajtohet me rigorozitet sipas vendimit të Këshillit të rregullimit të Territorit.</p>							
ii. Synimi i projektit							
<p>Qëllimi kryesor i bashkëpunimit është që të sigurojë një zonë më të pastër, më të sigurtë dhe më tërheqëse duke synuar sigurimin e burimeve të nevojshme për financimin e programeve dhe shërbimeve publike shtesë për t’iu përshtatur nevojave të biznesit duke krijuar një zonë biznesi që ka aftësi të konkurrojë përmes organizimit të ngjarjeve kulturore, argëtuese, sensibilizuese me qëllim tërheqjen e kalimtarëve të rregullt si dhe turistëve.</p>							
iii. Aktivitetet kryesore të projektit							
<p>1. Bashkia Shkodër do të mbështesë me mjete financiare nëpërmjet transferimit të ardhurave, nga tarifat që mbliken nga Bashkia Shkodër, nga bizneset anëtare të shoqatës sipas marrëveshjes së bashkëpunimit të miratuar me VKB, nr. 13, datë 12.03.2012.</p>							
b) Rezultatet që prisni							
<p>Forcimi dhe zhvillimi i bizneseve egzistuese, krijimi i bizneseve të reja si dhe rritja e cilësisë së shërbimit për vizitorin, që ndodhen përgjatë rrugës “13 Dhjetori”, “28 Nëntori” dhe “Kolë Idromeno”.</p>							
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt			
<p>Bashkia Shkodër AADF BID Shkodër</p>				<p>Bashkia Shkodër</p>			
e) Shpenzimet e llogaritura							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (000 lekë)	Nga kjo:				
A.1	Transferimi i të ardhurave nga tarifat që mbliken nga Bashkia Shkodër, nga bizneset anëtare të shoqatës, të përcaktuara sipas listës së aprovuar.	600	Paga	Sigurime	Operativ e	Transferim e	Kapital e
Shuma		600				600	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (000 lekë)	Nga kjo:				
A.1	Transferimi i të ardhurave nga tarifat që mbliken nga Bashkia Shkodër, nga bizneset anëtare të shoqatës, të përcaktuara sipas listës së aprovuar.	1,600	Paga	Sigurime	Operativ e	Transferim e	Kapital e
Shuma		1,600				1,600	

Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (000 lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Transferimi i të ardhurave nga tarifat që mbliidhen nga Bashkia Shkodër, nga bizneset anëtare të shoqatës, të përcaktuara sipas listës së aprovuar.	1,600				1,600
Shuma		1,600				1,600
f) Periudha e zbatimit 2025,2026,2027		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër				

Nr. 8	P.AC141.Q1.O3.A2. Mbështetje per bizneset Agro	Programi AC141: Mbështetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i. Situata						
<p>Njohja e territorit dhe promovimi i vlerave të tij në funksion të zhvillimit ekonomik është një nga prioritetet kryesore të politikave zhvilluese të Bashkisë Shkodër. Integrimi i këtyre elementeve me ofertën turistike, përfaqësojnë një potencial të rëndësishëm për zhvillimin e mëtejshëm të territorit.</p> <p>Bashkia Shkodër falë pozicionit të saj gjeografik dhe burimeve natyrore që disponon, ofron mundësi të mëdha për zhvillim ekonomik. Baza ekonomike e Bashkisë Shkodër përqendrohet në blegtori, veçanërisht në zonën malore, ndërsa në zonën fushore, bujqësia, sidomos prodhimi i drithërave, ka prioritet. Përveç këtyre, zona ofron produkte të tjera tipike, të tilla si verërat, vajin e ullirit dhe fruta-perime. Gjithashtu, afërsia me liqenin ka kontribuar në zhvillimin e peshkimit. Qyteti dhe zonat fushore e malore të Bashkisë Shkodër janë të njohura edhe për prodhimet artizanale, si punimet nga thupra, bakri, argjendi e druri, si dhe për qëndisimat dhe qilimat. Kjo pasuri mund të shqyrtohet nga këndvështrime të ndryshme, pasi përbën një fushë të gjerë, ku produktet agropërpunuese zënë një rol të rëndësishëm. Sektori i agropërpunimit përfshin proceset e transformimit të produkteve bujqësore dhe të blegtorisë në produkte të gatshme për konsum, si dhe në mallra me vlerë të shtuar. Ky sektor luan një rol të rëndësishëm në rritjen e ekonomisë lokale, duke ofruar mundësi punësimi dhe duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të zonës. Përveç kësaj, agropërpunimi ndihmon në ruajtjen e traditave lokale dhe në promovimin e produkteve vendase në tregjet kombëtare dhe ndërkombëtare. Përtej potencialeve të mëdha që ofron sektori agropërpunues, ky sektor ndeshet me disa problematika që kanë të bëjnë kryesisht me investimet për modernizimin e teknologjisë, standardizimin, konkurrueshmërinë, nxitjen e promovimit të markave rajonale, kapacitetet menaxhuese etj.</p> <p>Për të mbështetur zhvillimin e bizneseve agro, Bashkia Shkodër do të ndërmarrë një sërë aktiviteteve nxitëse në njësitë administrative të saj me qëllim promovimin e pasurive natyrore, kulturore dhe produkteve vendase. Në mbështetje të bizneseve. Në këto aktivitete, njësitë administrative do të ketë mundësinë të prezantojë potencialet e zhvillimit të produkteve vendase, duke përfshirë pasuritë natyrore dhe kulturore të zonës, si dhe ushqimin tradicional.</p>						
ii. Synimi i projektit						
Ky projekt synon rritjen e kapaciteteve të fermerëve /sipermarrësve të rinj, promovimin e sipermarrjeve rinore Agro si dhe produkteve vendase me qëllim zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të njësisve administrative të Bashkisë Shkodër.						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ol style="list-style-type: none"> 1. Analiza e situatës në territorin e Bashkisë Shkodër; 2. Ndertimi i rrjetit të fermerëve të rinj nga njësi të ndryshme administrative; 3. Trajnim mbi sigurinë ushqimore, marketimin dhe brandimin; 4. Sesion informues mbi funksionimin e rrjetëzimit (ndërveprimi), rëndësia e përfshirjes në rrjetin e fermerëve; 5. Hartimi i një plani veprimi komunikimi që do të shërbejë për promovimin e aktiviteteve. 6. Organizimi i panairëve agropërpunuese 						
b) Rezultatet që prisni						
<ul style="list-style-type: none"> - Rritja e kapaciteteve të sipermarrësve të rinj; - Numri i nismave rinore të mbështetura në sektorin Agro 						
c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen)			d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht, etj.)			
Bashkia Shkodër Dhoma e Tregtisë Biznese Prodhuesish Shoqata që operojnë në këtë fushë Banorët e Nj. Administrative			Bashkia Shkodër Donatorë			
e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii)						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transfere

A.1	Oranizimi i aktiviteteve per rritjen e kapaciteteve te sipermarresve te rinje dhe Mbështetje e Iniciativave Rinore ne sektorin Agro.	2,000			2,000		
	Shuma	2,000			2,000		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferrime	Kapitale
A.1	Oranizimi i aktiviteteve per rritjen e kapaciteteve te sipermarresve te rinje dhe Mbështetje e Iniciativave Rinore ne sektorin Agro.	2,000			2,000		
	Shuma	2,000			2,000		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferrime	Kapitale
A.1	Oranizimi i aktiviteteve per rritjen e kapaciteteve te sipermarresve te rinje dhe Mbështetje e Iniciativave Rinore ne sektorin Agro.	2,000			2,000		
	Shuma	2,000			2,000		
f) Periudha e zbatimit 2025,2026,2027		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër					

Nr. 9	P.AC141.Q1.O3.A3. Skeme granti per biznese inovative	Programi AC141: Mbështetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural
-------	---	---

a) Përshkrim i shkurtër i projektit:

i. Situata

Zbatimi i politikave vendore për mbështetjen dhe rritjen e kapaciteteve të bizneseve përbën një sfidë, prandaj është e rëndësishme të përqendrohemi në inkurajimin e iniciativave që nxisin dhe zhvillojnë bizneset e reja dhe ekzistuese. Një gjë e tillë është thelbësore për ndërtimin e një ekonomie të fortë, konkurrese dhe inovative.

Në këtë kontekst, Bashkia Shkodër synon të forcojë bashkëpunimin me sektorin privat, për të ofruar një qasje të qëndrueshme dhe efektive, e orientuar drejt zhvillimit ekonomik dhe e bazuar në një skemë granti për financimin e të individëve mbi moshën 18 vjeç që kanë një ide apo kanë një biznes ekzistues të vogël ose të mesëm dhe janë të regjistruar në Bashkinë Shkodër. Kjo, jo vetëm si një detyrim ligjor, por edhe si një praktikë e mirë, të cilën parashikon ta zbatojë në vitet në vazhdim për disa sektorë të ekonomisë. Skema e grantit financohet nga burime publike të buxhetit të Bashkisë Shkodër dhe është projektuar për të mbështetur financiarisht individëve/sipërmarrësve aspirantë, por edhe bizneseve të vogla dhe të mesme ekzistuese.

Skema e grantit do të zbatohet përmes një procesi konkurimi, për të marrë kështu fitimin më të lartë të mundshëm nga investimi. Thirrja për shprehjen e interesit do të shpallen në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër dhe do të qendrojë e hapur jo më pak se 4 javë nga dita e shpalljes. Procesi i përzgjedhjes së aplikantëve ka si qëllim të ofrojë transparencë dhe konkurrencë të barabartë si dhe të mbështesë idetë dhe planet e biznesit më të mira, fitimprurëse dhe që garantojnë rezultate të qëndrueshme. Skema do të zbatohet në të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër.

Për vitin 2024, Bashkia Shkodër ka shpallur thirrjen: "Skemë granti për të rinjtë", financuar nga burime të veta. Thirrja është shpallur në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër dhe është në proces zbatimi. Gjithashtu janë organizuar një sërë aktivitetsesh informuese gjatë kohëzgjatjes së thirrjes, me qëllim njohjen e aplikuesve të mundshëm me kriteret e kësaj skeme, mënyrën e aplikimit, etj. Kjo mbështetje financiare është një mundësi e mirë për sipërmarrësit që duan të angazhohen në zhvillimin e zgjidhjeve që stimulojnë rritjen ekonomike.

Në rast se aplikimi shpallet fitues, Bashkia Shkodër do të kërkojë që individit të regjistrohet si entitet ligjor përpara se të nënshkruhet kontrata dhe të disbursohen fondet.

ii. Synimi i projektit

Promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik nëpërmjet eko-inovacionit.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

1. Hartimi dhe miratimi i paketës së thirrjes për ide të gjelberta nga Këshilli Bashkiak Shkodër, në zbatim të ligjit për ndihmen shtetërore 9374, datë 21.04.2005, i ndryshuar.
2. Shpallja e thirrjes dhe përzgjedhja e ideve fituese.
3. Lidhja e kontrates, zbatimi dhe monitorimi i projekteve fituese.

b) Rezultatet që prisni

- Ngritje e kapaciteteve institucionale.
- Përmirësim i shërbimeve me standarde europiane.
- Nxitja e ekonomisë rrethore dhe mundësi të reja të zhvillimi.

c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen)

Bashkia Shkodër
Ministria e Financave dhe ekonomisë
Universiteti Luigj Gurakuqi

d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht, etj.)

Bashkia Shkodër
Institucione financiare
Programet e BE-së
Organizatave ndërkombëtare.

e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii))

Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mijë lekë)	Nga kjo				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Organizimi dhe shpallja e thirrjes për ide/biznese inovative						
A.2	Ekspertë të jashtëm për mentorimi (Honorore 2 persona * 6 ditë/personi)						
A.3	Honorar për komisionin e vlerësimit (2 persona * 2 ditë/personi)						
A.4	Grant për mbështetjen e ideve/bizneseve inovative						

Shuma		0					
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mijë lekë)	Nga kjo				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Organizimi dhe shpallja e thirrjes për ide eko-inovative						
A.2	Ekspertë të jashtëm për mentorimi (Honorore 2 persona * 6 ditë/personi)						
A.3	Honorar për komisionin e vlerësimit (2 persona * 2 ditë/personi)						
A.4	Grant për mbështetjen e ideve/bizneseve inovative	2,300				2,300	
Shuma		2,300				2,300	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Organizimi dhe shpallja e thirrjes për ide eko-inovative						
A.2	Ekspertë të jashtëm për mentorimi (Honorore 2 persona * 6 ditë/personi)						
A.3	Honorar për komisionin e vlerësimit (2 persona * 2 ditë/personi)						
A.4	Grant për mbështetjen e ideve/bizneseve inovative	2,300				2,300	
Shuma		2,300				2 300	
f) Periudha e zbatimit 2025,2026,2027			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:				
			Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit				
			Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër				

Nr.10	P.AC141.Q2.O1.A1 Mirëmbajtje e tregjeve ekzistuese	Programi AC141: Mbështetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i. Situata						
Bashkia ofron një program për mirëmbajtjen e tregjeve ekzistuese, i cili synon të përmirësojë infrastrukturën dhe shërbimet në këto hapësira. Ky program përfshin aktivitete si pastrimi, riparimi i ambienteve, përmirësimi i aksesit dhe krijimi i kushteve më të mira për tregtarët dhe konsumatorët, riparime në infrastrukture të tezgave, banakeve, lysterje, mirëmbajtje në banjo publike, elektricitet, uje, riparime në ambientet e magazinimit të mallit. Qëllimi është të sigurohet një ambient i pastër dhe tërheqës, i cili nxit aktivitetin ekonomik dhe mbështet zhvillimin e komunitetit lokal. Përmes këtij programi, bashkia angazhohet të përmirësojë cilësinë e shërbimeve, duke kontribuar në rritjen e besimit të qytetarëve dhe rritjen e frekuencimit të tregjeve. Gjithashtu në këtë program përfshihen konsultime me tregtarët dhe banorët për të siguruar që nevojat e tyre të merren parasysh në procesin e përmirësimit.						
ii. Synimi i projektit						
Një nga synimet e këtij programi është të krijohet një ambient funksional dhe tërheqës për tregtarët dhe konsumatorët, duke kontribuar në përmirësimin e higjenes dhe duke promovuar produktet lokale.						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
1. Vlerësimi i kërkesës për mirëmbajtjen e tregjeve 2. Ofrimi i shërbimeve të mirëmbajtjes dhe riparimeve të nevojshme për të siguruar qëndrueshmërinë e kushteve të tregtimit.						
b) Rezultatet që prisni						
Tregje operative që përmbushin standardet dhe sigurojnë kushte të përshtatshme për veprimtari tregtare të favorshme.						
c)Aktorët e mundshëm				d)Kontributet e mundshme në projekt		
Bashkia Shkodër Fermerët				Bashkia shkodër		
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Shërbime të mirëmbajtjes për ruajtjen dhe qëndrueshmërinë e kushteve të tregtimit					
A.2	Pagesat e shërbimeve me te trete (energji elektrike dhe uje.					
	Shuma					
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Shërbime të mirëmbajtjes për ruajtjen dhe qëndrueshmërinë e kushteve të tregtimit					
A.2	Pagesat e shërbimeve me te trete (energji elektrike dhe uje.					
	Shuma					
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Shërbime të mirëmbajtjes për ruajtjen dhe qëndrueshmërinë e kushteve të tregtimit					
A.2	Pagesat e shërbimeve me te trete (energji elektrike dhe uje.					
	Shuma					

f) Periudha e zbatimit 2025,2026,2027	g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Planifikimit strategjik dhe e përmirësimit të Klimës së biznesit Drejtoria e Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve Drejtoria e shërbimeve Publike Institucioni likujdues: Bashkia Shkodër
--	---

Nr.11	P.AC141.Q2.O1.A2. Tregu i produkteve bujqësore Velipojë	Programi AC141: Mbështetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i. Situata						
<p>Velipoja është një ndër qendrat më të rëndësishme të turizmit bregdetar, gjithësesi mungojnë tregjet dhe nuk janë në kushte cilësore përsa i përket pastërtisë dhe shërbimeve që ofrohen ndaj qytetarit. Përgjatë sezonit të verës në këtë njësi administrative kemi praninë e shumë vizitorëve dhe turistëve të cilët përveq shërbimeve turistike kanë edhe nevoja për të konsumuar produkte të ndryshme të cilat duhet të tregtohen në ambientet e posaqme. Rrjeti i tregtisë në bashkinë Shkodër duhet të plotësohet me tregjet lokale të shpërndara në njësitë administrative, ku do të promovohet zhvillimi ekonomik lokale veçanërisht në zonat turistike dhe bujqësore të populluara si Shkodra (të paktën nga një treg për njësi) dhe Velipoja (2 tregje të cilat do të funksionojnë gjatë periudhës së verës). Tregjet duhet të shihen përtej hapësirës së tregtimit edhe si hapësirë sociale dhe rekreative. Në këto hapësirat rekreative duhet të shërbehen vetëm produkte vendase, pra distanca nga tregu në tavolinë duhet të jetë 0km.</p> <p>Popullsia e përhershme në plazhin e Velipojës është rritur dukshëm duke arritur nga 387 në vitin 1990, në 2 075 banorë në 2016. Në vitin 2005 gjatë periudhës së verës, numri i pushuesve arrinte në 80 000, sipas statistikave gjate vitit arrijnë mesatarisht deri në 100 000 pushues në fundjavat e pikut të sezonit. Duke marrë parasysh sasinë e lartë të produkteve të konsumuara si dhe nevojën për një mjedisi të përshtatshëm për tregtim, nevoja për ndërtimin e tregut është shumë e madhe. Duke qënë një zonë e cila ka edhe karakteristika bujqësore si dhe të shfrytëzimit të akuakulturës dhe peshkimit, impakti i ndërtimit të një tregu me hapsirat e përshtatshme të magazinimit e tregtimit, do të jetë shumë i lartë edhe në zhvillimin ekonomik. Krijimi i tregut formalizuarakushërbimi dhe kontrollingaana e institucioneve është me efektiv, eshtenje hap i nevojshem që duhet ndërmarrë në mënyrë që të kemi një integrim dhe standartizim të ekonomive rurale me sistemin ekonomik të bashkisë Shkodër.</p> <p>Ndërtimi i tregjeve të rinj është një proces kompleks që kërkon investime kapitale të konsiderueshme. Ai duhet të mbështetet tek një studim në lidhje me kërkesat e përcaktuara qysh më parë në lidhje me ambientet dhe tek një vlerësim i plote financiar. Përdoruesit e këtyre ambienteve dhe kushteve përfunksionimin e strukturave duhet të përfshihen në procesin e projektimit qysh në fillim .Kjo kërkon konsultime dhe një fushatë ndërgjegjësimi me fermerët, furnizuesit, transportuesit, tregtarët, punonjësit e tregut dhe autoritetet lokale.</p>						
ii. Synimi i projektit						
Formalizimi i tregtimit të shitjes me pakicë në njësinë administrative Velipojë dhe sigurimi i kushteve të pershtatshme të tregtimit: Mbështetja prodhuesve vendas të bujqësisë, peshkimit dhe akuakulturës, rritja e tregtimit të produkteve si dhe siguria ushqimore.						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ol style="list-style-type: none"> 1. Studim i fizibilitetit të investimit 2. Aktivitete parapërgatitore (Projekti Teknik) 3. Ndërtimi i tregut të shitjes Velipojë 4. Rregullim i ambjenteve të tregjeve 5. Ngritja e ambjenteve për trajtimin e mbetjeve organike 6. Ndërtimi i infrastrukturës mbështetëse. 						
b) Rezultatet që prisni						
Ndërtim i një tregu të ri të shitjes me pakicë të produkteve lokale të njësisë administrative Velipojë						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt		
Bashkia Shkodër Ministria e bujqësisë, Azhbr Universiteti i Shkodër FSHZH				Bashkia Shkoder		
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Hartimi i projektit teknik					
A.2	Ndërtimi i tregut të shitjes Velipojë					
Shuma						
f) Periudha e zbatimit 2025,2026,2027			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e planifikimit strategjik dhe përmirësimit të kllmës së biznesit Drejtoria e Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve Institucioni likujdues: Bashkia Shkodër			

Nr.12	P.AC141.Q2.O1.A3						
Ndërtimi i tregut multifunksional të produkteve agro-ushqimore lokale		Programi AC141: Mbështetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural					
a) Përshkrim i shkurtër i projektit:							
i. Situata							
<p>Nga vlerësimi i interesit dhe studimi i fizibilitetit për ndërtimin e tregjeve del e domosdoshme ndërtimi i strukturave të reja për tregtimin me pakicë të produkteve bujqësore e blegtorale. Fermerët/tregtarët të cilët shesin produktet e tyre sezonale në kushte jo të favorshme duhen mbajtur parasysh për tu zgjidhur, pasi edhe kërkesat e tyre janë të shumta për përcaktim të një vendi stabil me kushte të përshtatshme tregtimi. Në territorin e Bashkisë Shkodër qytet janë evidentuar rreth 450 fermerë/tregtarë informal që kane nevojë për sistemim në një vend të përshtatshëm tregëtimi. Gjithashtu në Nj.A. e Bashkisë Shkodër ka kërkesë të vazhdueshme për ngritjen e një tregu për produktet vendase. Ndërtimi i Tregut Agroushqimor në qytet apo dhe në Nj.A., si një treg shumë-funksional dhe modern, i cili respekton ambientin dhe është në përputhje me standardet e sigurisë ushqimore gjithashtu rrit potencialin prodhues të sektorit bujqësor.</p> <p>Ndërtimi i tregjeve të rinj është një proces kompleks që kërkon investime kapitale të konsiderueshme. Ai duhet të mbështetet tek një studim në lidhje me kërkesat e përcaktuara qysh më parë në lidhje me ambientet dhe tek një vlerësim i plote financiar.</p> <p>Në kuadër të ndërhyrjeve të Bashkisë Shkodër për zhvillimin ekonomik po bëhet planifikimi për ndërtimin e një tregu të shitjes me pakice për produkte lokale agroushqimore për të zhvilluar tregti të formave të standardizuara. Krijimi i tregjeve të formalizuara ku shërbimi dhe kontrolli nga ana e institucioneve janë më efektive, është një hap i nevojshëm që duhet ndërmarrë në mënyrë që të kemi një integrim dhe standardizim të kësaj ekonomie informale me sistemin ekonomik të Bashkisë Shkodër.</p>							
ii. Synimi i projektit							
Formalizimi i tregtimit të shitjes me pakicë në territorin e Bashkisë Shkodër dhe sigurimi i kushteve të përshtatshme të tregtimit nëpërmjet ngritjes së tregut sipas standardeve.							
iii. Aktivitetet kryesore të projektit							
<ol style="list-style-type: none"> 1. Analiza e prodhimit aktual dhe të ardhshëm të fruta-perimeve; 2. Analiza e fluksit të tregtimit të prodhimeve ekzistuese; 3. Analiza e infrastrukturës ekzistuese të tregjeve dhe evidentimi i nevojës 4. Hartimi i projektit teknik për ndërtimin e tregut të shitjes me pakicë. 5. Ndërtimi i tregut në të shitjes me pakicë 6. Mbikqyrje 7. Kolaudimi 							
b) Rezultatet që prisni							
<ol style="list-style-type: none"> 1) Ndërtimi i tregut Agroushqimor për produktet vendase 2) Rritje e sigurisë ushqimore 3) Rritje e kënaqësinë së konsumatorëve 							
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt			
Bashkia Shkodër				Bashkia Shkodër			
e) Shpenzimet e llogaritura							
Shpenzimet për çdo aktivitet		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Projektimi						
A.2	Ndërtimi, mbikqyrja dhe kolaudimi i Tregut						
	Shuma						
f) Periudha e zbatimit 2025,2026,2027		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit Drejtoria e Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve Institucioni likujdues: Bashkia Shkodër					

Nr. 13	P.AC141.Q3.O1.A1. Hostim, mirëmbajtje, përditësim dhe shërbime shtesë për web sitin e turizmit.	Programi AC141: Mbështetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i. Situata Një ndër instrumentet më të fuqishëm dhe më aktual të promovimit është promovimi online. Krijimi i një faqeje të dedikuar për turizmin është i rëndësishëm pasi përveç se shërben si një platformë për të shpërndarë informacion rreth një destinacioni, duke lehtësuar planifikimin e udhëtimit për vizitorët, vepron dhe si një mjet i fuqishëm marketingu, duke promovuar veçoritë dhe atraksionet unike të Bashkisë Shkodër. Duke ofruar harta interaktive, rekomandime të personalizuar dhe përditësime në kohë reale, kjo faqe webi do të përmirësojë përvojën e përgjithshme të vizitorëve. Njëpërmjet veçorive si vlerësimet e përdoruesve dhe integrimi i mediave sociale nxitet angazhimin i përdoruesve. Udhëtarët mund të ndajnë përvojat e tyre, duke ofruar komente të vlefshme dhe duke ndikuar në vendimet e udhëtimit të tjerëve. Në kuadër të projektit Tourism4Albania është realizuar web site zyrtar, dedikuar turizmit. Projekti ka filluar në maj të vitit 2022 dhe do të vazhdojë deri në maj të 2025. Pas përfundimit faqja do të mirëmbahet nga bashkia. Përditësimi dhe mirëmbajtja e faqes është thelbësore për ruajtjen e saktësisë, rëndësisë, besimit të përdoruesve dhe konkurrencës. Siguron që platforma të mbetet një burim i besueshëm dhe i vlefshëm si për vizitorët e mundshëm ashtu edhe për komunitetin lokal.						
ii. Synimi i projektit						
Synohet promovimi i destinacionit, përmirësimi i informacionit për vizitorët me qëllim zhvillimin ekonomik të bashkisë Shkodër.						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ul style="list-style-type: none"> • Hostimi. • Mirëmbajtja. • Përditësim e shërbime shtesë. 						
b) Rezultatet që prisni						
Ëëbsite i mirëmbajtur dedikuar turizmit të Bashkisë Shkodër.						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt		
<ul style="list-style-type: none"> • Drejtoritë e ndryshme të Bashkisë (E Turizmit, e Kulturës, e Planifikimit të Territorit, Planifikimit Strategjik, e të Ardhurave etj. • Universiteti i Shkodrës • Bizneset 				<ul style="list-style-type: none"> • Bashkia Shkodër. • Bizneset përfituese të turizmit. • Shoqata e Artizanëve • ATA 		
e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii)						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime Kapitale
A.	Hostim, mirëmbajtje, përditësim dhe shërbime shtesë për ëeb sitin e turizmit.	0			0	
Shuma		0			0	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime Kapitale
A.	Hostim, mirëmbajtje, përditësim dhe shërbime shtesë për ëeb sitin e turizmit.	150			150	
Shuma		150			150	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime Kapitale
A.	Hostim, mirëmbajtje, përditësim dhe shërbime shtesë për ëeb sitin e turizmit.	150			150	
Shuma		150			150	
f) Periudha e zbatimit 2025,2026,2027		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Stafi i drejtorisë së Turizmit. Institucioni likujdues: Bashkia Shkodër				

<p>Nr. 14</p>	<p>P.AC141.Q3.O1.A2. Hostim , mirëmbajtje , pëditesim dhe shërbime shtesë për aplikacionin e turizmit</p>	<p>Programi AC141: Mbështetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural</p>								
<p>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</p>										
<p>i. Situata</p>										
<p>Zhvillimi i turizmit është gjithnjë e më shumë në fokusin e Bashkisë Shkodër dhe githashtu vërehet një interes gjithnjë e në rritje i turistëve të huaj dhe vendas. Përparimet teknologjike i kanë dhënë mundësinë të gjithëve për të pasur akses më të shpejtë e më të lire në informacionin për destinacione të caktuara. Krijimi i aplikacionit synon që të lehtësojë udhëtimin e turistëve vendas dhe sidomos të huaj nëpër pikat e ndryshme turistike të Shkodrës në zbulim të trashëgimisë historike, natyrore e kulturore. Në të njëjtën kohë, ky aplikacion do të ndihmojë edhe bizneset e ndryshme që ofrojnë shërbime turistike për të zgjeruar aktivitetin e tyre, duke reklamuar në faqen e dedikuar të aplikacionit. Risia që do i ofrohet turistëve është vetë aplikacioni offline në ndihmë të klientëve, për të kursyer në tarifat e Internetit roaming apo për të zgjidhur pamundësinë e të pasuritit Ëi-Fi. Çdokush mund ta organizojë udhëtimin e tij nëpërmjet aplikacionit që do të jetë në celularin e tij në çdo moment, gjë që kursen jo vetëm shpenzime, por edhe kohë. Ky do të ishte një hov cilësor për tregun e turizmit në Shkodër, sepse është mundësia që ndryshimet të përditësohen nëkohë të shpejtë. Për të ofruar një cilësi sa më të lartë shërbimi të informacionit për turistët dhe për të përmirësuar sigurinë nevojitet që aplikacioni të mirëmbahet dhe azhurnohet në vazhdimësi. Kjo do ndikonte mjaft në zhvillimin e mëtejshëm të turizmit në Bashkinë Shkodër.</p>										
<p>ii. Synimi i projektit</p>										
<p>Synohet përmirësimi dhe lehtësimi i aksesit të informacionit për vizitorët.</p>										
<p>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</p>										
<ul style="list-style-type: none"> • Dizenjimi dhe krijimi i platformës • Hostimi. • Mirëmbajtja. • Përditësim e shërbime shtese. 										
<p>b) Rezultatet që prisni</p>										
<p>Një aplikacion dinamik për turizmin informacioni lehtësisht të arritshëm.</p>										
<p>c) Aktorët e mundshëm</p>					<p>d) Kontributet e mundshme në projekt</p>					
<ul style="list-style-type: none"> •Stafi i Bashkisë.(Drejtorja e Turizmit, Drejtorja e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit, etj) •Agjensia Kombëtare e Turizmit 					<ul style="list-style-type: none"> •Bashkia Shkodër. •Bizneset përfituese të turizmit. •ATA 					
<p>e) Shpenzimet e llogaritura</p>										
<p>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025</p>					<p>Totali (mije lekë)</p>	<p>Nga kjo:</p>				
						<p>Pag a</p>	<p>Sigurim e</p>	<p>Operativ e</p>	<p>Transferim e</p>	<p>Kapital e</p>
<p>A.1</p>	<p>Hostim, mirëmbajtje, përditësim dhe shërbime shtesë për aplikacionin e turizmit.</p>				<p>0</p>			<p>0</p>		
<p style="text-align: center;">Shuma</p>					<p>0</p>			<p>0</p>		
<p>Shpenzimet për çdo aktivitet 2026</p>					<p>Totali (mije lekë)</p>	<p>Nga kjo:</p>				
						<p>Pag a</p>	<p>Sigurim e</p>	<p>Operativ e</p>	<p>Transferim e</p>	<p>Kapital e</p>
<p>A.1</p>	<p>Hostim, mirëmbajtje, përditësim dhe shërbime shtesë për aplikacionin e turizmit.</p>				<p>0</p>			<p>0</p>		
<p style="text-align: center;">Shuma</p>					<p>0</p>			<p>0</p>		
<p>Shpenzimet për çdo aktivitet 2027</p>					<p>Totali (mije lekë)</p>	<p>Nga kjo:</p>				
						<p>Pag a</p>	<p>Sigurim e</p>	<p>Operativ e</p>	<p>Transferim e</p>	<p>Kapital e</p>
<p>A.1</p>	<p>Hostim, mirëmbajtje, përditësim dhe shërbime shtesë për aplikacionin e turizmit.</p>				<p>0</p>			<p>0</p>		
<p style="text-align: center;">Shuma</p>					<p>0</p>			<p>0</p>		
<p>f) Periudha e zbatimit 2025,2026,2027</p>					<p>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Stafi i drejtorisë së turizmit. Institucioni likujdues: Bashkia Shkodër</p>					

Nr. 15	P.AC141.Q3.O1.A3. Prodhim, publikim dhe botim i materialeve promociionale	Programi AC141: Mbështetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i. Situata						
Turizmi është një sektor prioritar i zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror edhe për ekonominë e bashkisë Shkodër. Ai gjeneron të ardhura më të larta për faktin që një sërë aktivitetesh ekonomike janë të lidhura me të, si dhe garanton punësim dhe mundësi vetëpunësimi. Me pasuri të veçanta natyrore, historike dhe me një pasuri të trashëgimisë kulturore, Shkodra ka një potencial të jashtëzakonshëm turistik. Për të krijuar një identitet më të njohur për turizmin në Shkodër, për të përmirësuar konkurrencën dhe për të përmirësuar pozicionin në tregun turistik kombëtar, rajonal si dhe duke parë fluksin e turistëve dhe mbajtjen e tyre sa më gjatë në destinacionin tone, Drejtoria e Turizmit çdo vit ka realizuar botime të ndryshme dhe prodhuar materiale promociionale (guidën turistike, hartën turistike të territorit të Bashkisë; harta të destinacioneve specifike- Shkodër; Theth dhe Velipojë; itinerare të ndryshme turistike, kalendarin e aktiviteteve kulturore dhe artistike, materiale të ndryshme promociionale dhe publikime online si reklama etj. Për vitet në vazhdim, është menduar që fondi i parashikuar për realizimin e këtyre aktiviteteve të kryhet me blerje të përqendruar. Të gjitha materialet promociionale që do të realizohen do të jenë në dispozicion të zyrave të informacionit turistik të Bashkisë falas.						
ii. Synimi i projektit						
Përmirësimi i informacionit turistik dhe diversifikim i ofertës turistike të Bashkisë Shkodër.						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ul style="list-style-type: none"> • Përmirësimi dhe rifreskimi i i informacionit në territorin e Bashkisë Shkodër. • Prodhimi dhe botimi i materialeve promociionale • Shpërndarja e materialeve. 						
b) Rezultatet që prisni						
Rritja e numrit të turistive dhe kohëzgjatja e sezonit turistik në Bashkinë Shkodër.						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt		
<ul style="list-style-type: none"> • Stafi i Bashkisë, Drejtoria e turizmit 				<ul style="list-style-type: none"> • Bashkia Shkodër. • Bizneset përfituese të turizmit. 		
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Prodhim, publikim dhe botim i materialeve promociionale.	500			500	
Shuma		500			500	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Prodhim, publikim dhe botim i materialeve promociionale.	2,500			2,500	
Shuma		2,500			2,500	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Prodhim, publikim dhe botim i materialeve promociionale.	2,500			2,500	
Shuma		2,500			2,500	
f) Periudha e zbatimit 2025,2026,2027		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:				
		Stafi i Drejtorisë së Turizmit.				
		Institucioni likujdues: Bashkia Shkodër				

Nr.16	P.AC141.Q3.O1.A4 Përmirësimi i aksesit dhe mirëmbajtja e shtigjeve	Programi AC141: Mbështetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit						
i. Situata						
Territori i bashkisë Shkodër është ndër zonat më të pasura me burime natyrore, ku përfshihen edhe destinacionet më të frekuentura sa i takon turizmit natyror dhe atij malor. Këto zona turistike frekuentohen nga turistë kryesisht të huaj, të apasionuar pas ecjes në natyrë, alpinizmit, sporteve të aventurës por edhe për interesimin ndaj mënyrës autentike të jetesës së banorëve të zonës. Brenda zonave turistike ka mjaft pika tërheqëse me interes për vizitorët, të cilat vizitohen duke ecur në këmbë në shtigje që njihen nga guidat turistike të zonës. Këto shtigje kanë nevojë që të paisen me sinjalistikë të përshtatshme pasi ka një numër të madh vizitorësh të cilët vijnë në mënyrë të paorganizuar. Të gjitha facilitetet, përfshirë zonat rekreative dhe shtigjet për ecje, kanë nevojë për mirëmbajtje të rregullt për të zvogëluar dëmin e shkaktuar me kalimin e kohës dhe nga përdorimi. Mirëmbajtja e duhur është themelore për të garantuar sigurinë e vizitorëve, lehtësi në kalim, dhe për të inkurajuar përdorimin e itinerarit të caktuar.						
ii. Synimi i projektit						
Përmirësimi i shërbimit dhe informacionit për vizitorët.						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ul style="list-style-type: none"> - Identifikimi i nevojave për ndërhyrje në shtigje për pajisje me sinjalistikën dhe mirëmbajtjen e tyre. - Përgatitja e dokumentacionit tekniko-ligjor për garën e hapur për kryerjen e punimeve. - Kryerja e punimeve 						
b) Rezultatet që prisni						
Markimi i shtigjeve dhe paisja me sinjalistikën përkatëse e shtigjeve. Përmirësimi i standarteve dhe ofrimit të shërbimit përmes mirëmbajtjes së shtigjeve						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt		
<ul style="list-style-type: none"> - Stafi i Bashkisë - Bizneset turistike - Universiteti 				- Bashkia Shkodër.		
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mije lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Përmirësim i aksesit dhe mirembajtje e shtigjeve	600			600	
Shuma		600			600	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mije lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Përmirësim i aksesit dhe mirembajtje e shtigjeve	600			600	
Shuma		600			600	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mije lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Përmirësim i aksesit dhe mirembajtje e shtigjeve	1,000			1,000	
Shuma		1,000			1,000	
f) Periudha e zbatimit 2025,2026,2027		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Turizmit Institucioni likujdues: Bashkia Shkodër				

Nr.17	P.AC141.Q3.O1.A5. Pjesëmarrje në panair kombetare dhe ndërkombëtare për ofertën turistike të Shkodrës	Programi AC141: Mbështetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural					
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit							
i. Situata							
<p>Zhvillimi i turizmit në zonën e Shkodrës, ka ecur me shpejtësi. Nga viti në vit, numri i turistëve dhe vizitorëve ka ardhur në rritje. Rajoni jonë ofron një gamë të gjërë të produkteve bujqësore dhe gastronomike me shije krejt të veçanta që përbëjnë një element shumë të rëndësishëm të ofertës turistike të rajonit. Një sinergji më e konsoliduar mes bizneve turistike dhe atyre të produkteve bujqësore dhe gastronomike do të krijonte mundësinë për produktetë reja turistike duke rritur ndjeshëm numrin e tyre por edhe duke i përmirësuar cilësisht ato. Të gjithë këto vlera të qytetit tonë duhet të bëhen të njohura ndërkombëtarisht dhe pjesëmarrja në panair kombëtare dhe ndërkombëtare është një alternativë mjaft e mirë për këtë qëllim.</p>							
ii. Synimi i projektit							
<ul style="list-style-type: none"> Promovimi i destinacionit përmes diversifikimit të ofertës turistike të territorit të Bashkisë Shkodër në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare. 							
iii. Aktivitetet kryesore të projektit							
<ul style="list-style-type: none"> Mbledhja dhe sistemimi i informacionit për materialin që do prezantohet në panair. Prodhimi i materialeve promovionale për standin e panairit. Pjesëmarrja në panair. 							
b) Rezultatet që prisni							
<ul style="list-style-type: none"> Vizitorët që marrin pjesë në panair do të kenë një informacion më të plotë dhe të përditësuar për atraksionet dhe produktet turistike të territorit të Bashkisë Shkodër. 							
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet emundshmenë projekt			
<ul style="list-style-type: none"> Stafi i Bashkisë Bizneset turistike 				<ul style="list-style-type: none"> Bashkia Shkodër. 			
e) Shpenzimet e llogaritura							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Pjesëmarrje në panair (Organizim i te gjitha detajeve per realizimin e panairit)	800			800		
Shuma		800			800		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Pjesëmarrje në panair (Organizim i te gjitha detajeve per realizimin e panairit)	800			800		
Shuma		800			800		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Pjesëmarrje në panair (Organizim i te gjitha detajeve per realizimin e panairit)	1,500			1,500		
Shuma		1,500			1,500		
f) Periudha e zbatimit 2025,2026,2027		g) Përgatiti dhe ndjekrealizimin e projektit:					
		Drejtoria e Turizmit					
		Institucioni likujdues: Bashkia Shkodër					

Nr.18	P.AC141.Q3.O1.A6. Itineraret e shijes/promovimi i Slow food	Programi AC141: Mbështetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit						
i. Situata						
Shkodra njihet jo vetëm për natyrën e bukur, por edhe historinë, kulturën, rrugicat karakteristike si dhe artin e gatimit, që përcillet me aq finesë. Panairët e kulinarisë do të jenë një udhëtim përmes trashëgimisë së pasur gastronomike, kulturore, artistike, historike dhe bukurive natyrore të Shkodrës. Këto aktivitete synojnë t'i kthejnë Shkodrës vendin që i takon si një qytet ku turizmi zhvillohet mbi rrënjët e forta të traditës dhe pasurive të pafundme të territorit, ndërthurur me elementet që koha i dikton. Aktivitetet e kulinarisë synojnë të promovojnë itinerarët e shijes dhe traditën e pasur gastronomike në territorin e bashkisë Shkodër dhe të rajonit.						
ii. Synimi i projektit						
<ul style="list-style-type: none"> Rritja e numrit të turistëve në territorin e bashkisë Shkodër. 						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ul style="list-style-type: none"> Realizimi i panairit me bizneset lokale Organizimi i aktiviteteve si konkurse gatimi, degustime kulinare, trajnime në fushën gastronomisë etj Program artistik Fushatë promovuese 						
b) Rezultatet që prisni						
<ul style="list-style-type: none"> Promovimi i gastronomisë dhe produkteve lokale 						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet emundshmenëprojekt		
<ul style="list-style-type: none"> Stafi i Bashkisë Bizneset turistike 				<ul style="list-style-type: none"> Bashkia Shkodër. 		
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Realizimi i panairit (Organizimi i panairit, konkurse gatimi/degustime kulinare/ trajnimeve në fushën e gastronomisë; program artistik dhe fushatë promovuese)	1,200				1,200
Shuma		1,200				1,200
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Realizim i panairit (Organizimi i panairit, konkurse gatimi/degustime kulinare/ trajnimeve në fushën e gastronomisë; program artistik dhe fushatë promovuese)	1,500				1,500
Shuma		1,500				1,500
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Realizim i panairit (Organizimi i panairit, konkurse gatimi/degustime kulinare/ trajnimeve në fushën e gastronomisë; program artistik dhe fushatë promovuese)	1,500				1,500
Shuma		1,500				1,500
f) Periudha e zbatimit 2025,2026,2027		g) Përgatiti dhe ndjekrealizimin e projektit:				
		Drejtoria e Turizmit				
		Institucioni likujdues: Bashkia Shkodër				

Nr.19	P.AC141.Q3.O1.A7. Festa e Liqenit	Programi AC141: Mbështetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural					
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit							
i. Situata							
<p>Liçeni i Shkodrës përbën një ekosistem të rëndësishëm vlerash natyrore që ndërthuren me vlera historike e kulturore. Si liçeni më i madh në Rajonin e Ballkanit dhe zonë e mbrojtur e kategorisë IV - Rezervat Natyror i Menaxhuar, e bën një zonë me shumë vlera ekologjike me fokus zhvillimin e qëndrueshëm.</p> <p>Fundjava e javës së tretë të muajit qershor është përcaktuar si Dita e Liqenit të Shkodrës, e cila është një ditë e përbashkët e aprovuar nga të dy ministrat e Mjedisit respektive të Shqipërisë dhe Malit të Zi. Aktivitete të larmishme, për ditën e Liqenit të Shkodrës zhvillohen për çdo vit të cilët fokusohen në aktivitete promovuese social- kulturore, sportive me qëllim ruajtjen, mbrojtjen dhe zhvillimin e kësaj trashëgimie të pasur natyrore të qytetit si dhe në promovimin e produkteve rajonale dhe bizneseve lokale të Shkodrës.</p>							
ii. Synimi i projektit							
<ul style="list-style-type: none"> Te promovojë dhe te mbështesë zhvillimin e ekoturizmit në Liqenin e Shkodrës; 							
iii. Aktivitetet kryesore të projektit							
<ul style="list-style-type: none"> Organizimi i një sërë aktiviteteve sportive ujore; Ekspozita fotosh nga liçeni etj Panairi i artizanatit dhe kulinarise tradicionale Koncert kenge dhe valle me talentet te reja te qytetit 							
b) Rezultatet që prisni							
<ul style="list-style-type: none"> Promovimi i liqenit të Shkodrës si një burim ekonomik dhe turistik si edhe ndërgjegjësim i komunitetit për vlerat e tij mjedisore dhe të biodiversitetit. 							
c) Aktorët e mundshëm		d) Kontributet emundshmenëprojekt					
<ul style="list-style-type: none"> Bashkia Shkoder Universiteti "Luigj Gurakuqi" 		<ul style="list-style-type: none"> Bashkia Shkodër. OJF dhe TO 					
e) Shpenzimet ellogaritura							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Zhvillim i aktivitetit (transport, foni, Dj, qira mjete lundruese, paisje për aktivitetet sportive, baner, postera, lajmërime, bluza, kapele, certifikata, etj)	700				700	
Shuma		700				700	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Zhvillim i aktivitetit (transport, foni, Dj, qira mjete lundruese, paisje për aktivitetet sportive, baner, postera, lajmërime, bluza, kapele, certifikata, etj)	700				700	
Shuma		700				700	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Zhvillim i aktivitetit (transport, foni, Dj, qira mjete lundruese, paisje për aktivitetet sportive, baner, postera, lajmërime, bluza, kapele, certifikata, etj)	1,000				1,000	
Shuma		1,000				1,000	
f) Periudha e zbatimit 2025,2026,2027		g) Përgatiti dhendjekrealizimineprojektit: Drejtoria e Turizmit					
		Institucioni likujdues: Bashkia Shkodër					

Nr.20	P.AC141.Q3.O1.A8. Valorizimi dhe mbrojtja e trashëgimisë së zonave malore, përmes aktiviteteve promovuese.	Programi AC141: Mbështetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit						
i. Situata						
Rigjallërimi i trashëgimisë dhe zhvillimi i turizmit te zonave malore duke mbështetur promovimin e diversitetit kulturor dhe natyror ne keto zona, mbetet nje nder prioritete kryesore te Bashkise Shkoder. Qëllimi kryesor është të ngreje vetëdijen dhe të kuptuarit e vlerës së trashëgimisë ekzistuese si dhe të sigurohet përjetimi i kënaqësisë dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i burimeve të trashëgimisë nga komunitetet lokale. Zona e Alpeve është një nga destinacionet më atraktive të territorit të Bashkisë Shkodër e më gjërë. Ajo ofron mundësi të jashtëzakonshme për zhvillimin e shumë llojeve të turizmit malor dhe të aventurës. Zhvillimi i ketij aktiviteti është konceptuar në mënyrë të tillë, që të përmbajë sa më shumë elementë të traditës lokale dhe të promovojë në mënyrë sa më gjithë përfshirëse atraksionet e vecanta të ketij destinacioni.						
ii. Synimi i projektit						
<ul style="list-style-type: none"> Promovimi i vlerave natyrore dhe kulturore të zonës së Alpeve. 						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ul style="list-style-type: none"> Panair të vlerave tradicionale të zonës, si veshje popullore, tradita e kulinarisë, artizanati, Ekspozite me foto të jetës së egër nga kjo zonë, Koncert me këngë e valle të zonës së Alpeve Aktivitetet në natyrë si birdëatching, ture botanike, vizita në sitet dhe vizita në monumentet historike te zones Realizimi i materialeve promovuese 						
b) Rezultatet që prisni						
<ul style="list-style-type: none"> Mbështetja e iniciativave për aktivitete edukative dhe rekreative me fokus zhvillimin e turizmit në një mjedis të mirëmbajtur natyror 						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt		
<ul style="list-style-type: none"> Bashkia Shkodër Bizneset përfituese të turizmit.OJF Universiteti i Shkodrës, 				<ul style="list-style-type: none"> Bashkia Shkodër. 		
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime Kapitale
A.1	Organizimi i aktivitetit (materiale promicionale, transport, toure ne atraksionet turistike; panair; koncert, etj)	700				700
Shuma		700				700
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime Kapitale
A.1	Organizimi i aktivitetit (materiale promicionale, transport, toure ne atraksionet turistike; panair; koncert, etj)	700				700
Shuma		700				700
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime Kapitale
A.1	Organizimi i aktivitetit (materiale promicionale, transport, toure ne atraksionet turistike; panair; koncert, etj)	1,000				1,000
Shuma		1,000				1,000
f) Periudha e zbatimit 2025,2026,2027		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria eTurizmit Institucioni likujdues: Bashkia Shkodër				

Nr.21	P.AC141.Q3.O1.A9. Java e Mobilitetit	Programi AC141: Mbështetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit						
i. Situata						
Me qëllim promovimin e lëvizjes së qëndrueshme urbane të qytetit, ku prioriteti i jepet ecjes dhe pedalimit për të nxitur lëvizjen aktive dhe të shëndetshme, Bashkia Shkoder i ka kushtuar një vëmendje të vecante aplikimit të trendit të mobilitetit urban duke ndertuar korsite e bicikletave me një shtrirje të gjere ne te gjithë qytetin duke u përfshirë në mënyrë aktive në promovimin dhe mbrojtjen e kësaj kulture dhe tradite. Si cdo vit, gjate javes se mobilitetit ne muajin shtator, eshte parashikur nje seri aktivitetesh qe shtrihen gjate gjithë javes me perfshirjen e shume aktoreve, nxenesve te shkollave dhe qytetareve dhe qe kulton me “ ditën pa makina”.						
ii. Synimi i projektit						
<ul style="list-style-type: none"> Ripërtëritja e traditës dhe promovimi i mënyrës së shëndetshme të jetesës 						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ul style="list-style-type: none"> Aktivite të ndryshme me fokus biçikleten Xhiro demonstrative m ebicikleta Ekspozitë / konkurs fotografie Publikim i materialeve promociionale për përdorimin e biçikletës 						
b) Rezultatet që prisni						
Realizimi i kësaj feste do të rrisën dërgjegjësimin qytetar për përdorimin e biçikletës dhe do të krijojë një atmosferë festivenë qytet.						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt		
<ul style="list-style-type: none"> Bashkia Shkoder DAR 				<ul style="list-style-type: none"> Bashkia Shkodër. 		
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime Kapitale
A.1	Organizimi i aktivitetit.	500				500
Shuma		500				500
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime Kapitale
A.1	Organizimi i aktivitetit	500				500
Shuma		500				500
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime Kapitale
A.1	Organizimi i aktivitetit.	500				500
Shuma		500				500
f) Periudha e zbatimit 2025, 2026, 2027		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Turizmit Institucioni likujdues: Bashkia Shkodër				

Nr.22	P.AC141.Q3.O1.A10. Lojra Popullore Fest	Programi AC141: Mbështetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit						
i. Situata						
<p>"Lojra Popullore Fest" është një aktivitet me karakter social-kulturor për të rinjtë i cili synon jo vetëm të pasurojë jetën e të rinjve por edhe t'i njohë ata me traditat tona kombëtare me anën këngëve, valleve dhe lojrave popullore. Qëllimi i aktivitetit është promovojë paqen, tolerancën, miqësinë në mes të trupave pjesëmarrëse. "Lojra popullore fest" gjithashtu synon që të pasurojë jetën e të rinjve duke i angazhuar ato në identifikimin e vlerave njerëzore e vlerave folklorike e kombëtare e ndërkombëtare. Vetë të rinjtë konkurojnë me performanca me lojra popullore, këngë e valle të traditave kombëtare dhe etnografike. Projekti nxit rininë për promovimin e vlerave turistike. Ky aktivitet është kthyer në traditë për qytetin e Shkodrës.</p>						
ii. Synimi i projektit						
<ul style="list-style-type: none"> - Të pasurojë jetën social kulturore të të rinjve. - Të promovojë dhe t'i njohë ata me traditat e njesive administrative të Bashkisë Shkodër, te rajonit dhe me tej, me anë të performimeve të këngëve, valleve dhe lojrave popullore. - Të përfshijë të gjithë njësite administrative të Bashkisë së Shkodrës dhe rajonin, nëpërmjet përfaqësimit nga të rinjtë. 						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ul style="list-style-type: none"> - Përzgjedhja e trupave candidate për pjesëmarrje - Ngritja e bashkëpunimit me trupat e përzgjedhura - Përgatitja e ambjentit ku do zhvillohet aktiviteti: skena, sigurimi i nevojave bazë. 						
b) Rezultatet që prisni						
Promovimi i vlerave dhe traditave kulturore të njesive administrative të Bashkisë së Shkodrës dhe angazhimi i të rinjve përmes një pjesëmarrjeje të gjerë						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt		
<ul style="list-style-type: none"> - Staf i Bashkisë Shkodër (Drejtoria e Turizmit) - Komuniteti - Institucione publike 				<ul style="list-style-type: none"> - Bashkia Shkodër. - Qendra Kulturore e femijeve - ZVA Shkoder 		
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mije lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Organizimi i aktivitetit.	500				500
Shuma		500				500
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mije lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Organizimi i aktivitetit	500				500
Shuma		500				500
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mije lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Organizimi i aktivitetit.	500				500
Shuma		500				500
f) Periudha e zbatimit 2025,2026,2027		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:				
		Drejtoria e Turizmit				
		Institucioni likujdues: Bashkia Shkodër				

Nr. 23	P.AC141.Q3.O1.A11. Fushata marketing online	Programi AC141: Mbështetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i. Situata						
Fushata marketingut online është një aktivitet që përfshin përdorimin e kanaleve dhe mjeteve dixhitale për të promovuar një produkt, shërbim, markë ose kompani përmes internetit. Kjo lloj fushate është gjithnjë e më shumë e rëndësishme për bizneset dhe organizatat që kërkojnë të arrijnë një audiencë të gjerë dhe të përmirësojnë ndihmën për zhvillimin e shitjeve dhe rritjen e njohjes së markës. Marketingu online ka pësuar një zhvillim të jashtëzakonshëm në vitet e fundit, duke u bërë një komponent thelbësor për çdo strategji të biznesit dhe komunikimi. Si pasojë e avancimit të teknologjisë, rritjes së përdorimit të internetit, dhe ndryshimeve në sjelljen e konsumatorëve, marketingu online ka evoluar për t'u përshtatur me kërkesat e reja dhe për të krijuar mundësi të reja për të arritur audiencën						
ii. Synimi i projektit						
Rritja e Ndikimit të Markës: Krijimi i njohjes dhe ndërtimi i besueshmërisë së markës						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
Marketingu në rrjetet sociale SEO (Optimizimi i motorëve të kërkimit) Email Marketing Content Marketing						
b) Rezultatet që prisni						
Krijimi i nje imazhi cilesor dhe te qendrueshem te destinacionit.						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt		
<ul style="list-style-type: none"> • Bashkia Shkodër • Bizneset përfituese të turizmit. • OJF Universiteti i Shkodrës, • Fakulteti Ekonomik/Dega Turizëm 				<ul style="list-style-type: none"> • Bashkia Shkodër. • Bizneset përfituese të turizmit. 		
e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii)						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Fushata marketing online	600			600	
	Shuma	600			600	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Fushata marketing online	750			750	
	Shuma	750			750	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Fushata marketing online	0				
	Shuma	0				
f) Periudha e zbatimit 2025,2026,2027		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:				
		Stafi i drejtorisë së Turizmit.				
		Institucioni likujdues: Bashkia Shkodër				

Nr. 24	P.AC141.Q3.O1.A12. Shkodra: Histori dhe magji në çdo hap: promovim në lëvizje	Programi AC141: Mbështetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i. Situata						
<p>Një stendë lëvizëse për një ngjarje, panair, ose ekspozitë në Shkodër mund të jetë një element shumë efektiv për të tërhequr vëmendjen e vizitorëve dhe për të promovuar produkte, shërbime ose marka. Kjo mund të jetë një stendë që mund të lëvizë fizikisht përreth, ose një dizajn i veçantë që përdor elemente dinamike si ekrane të lëvizshëm, drita, ose efekte të tjera për të krijuar një përvojë tërheqëse. Territori i bashkisë Shkodër gjithnjë e më tepër po sheh një numër në rritje të turizmit të brendshëm. Gjykojmë një mënyrë e mirë për të ndërgjegjësuar turistët dhe për t'i informuar ata mbi atraksionet dhe mundësitë që ofron territori i Bashkisë Shkodër do të ishte ngritja e një stende të lëvizshme që do të vendosej në qytete të ndryshme të Shqipërisë në ditë të caktuara. Kjo stendë do të përmbante materiale promocionale për Shkodrën duke bërë në këtë mënyrë të rritet interesi i qytetarëve të atij qyteti për të vizituar Shkodrën. Bashkë me stendën do të udhëtojë edhe një pjesë e stafit të drejtorisë të cilët do të kryjnë funksionin e informacionit turistik si edhe të promovimit të qytetit.</p>						
ii. Synimi i projektit						
Të promovojë territorin e e Bashkisë Shkodër dhe të rrisë turizmin e brendshëm.						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<input type="checkbox"/> Organizimi i aktivitetit me pjesëmarrjen e bizneseve të Shkodrës dhe rajonit <input type="checkbox"/> Promovim dhe marketing I destinacionit						
b) Rezultatet që prisni						
Krijimi I nje përvojë tërheqëse dhe dinamike që tërheq audiencën dhe promovon markën dhe produktin rajonal në mënyrë efektive.						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt		
<ul style="list-style-type: none"> • Bashkia Shkodër • Bizneset përfituese të turizmit. • OJF Universiteti i Shkodrës, • Fakulteti Ekonomik/Dega Turizëm 				<ul style="list-style-type: none"> • Bashkia Shkodër. • Bizneset përfituese të turizmit. 		
e) Shpenzimet e logaritura (për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii))						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurim e	Operativ e	Transferi me
A.1	Mbeshtetja e iniciativave te reja ne mbeshtetje te zhvillimit te turizmit	500			500	
Shuma		500			500	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurim e	Operativ e	Transferi me
A.1	Mbeshtetja e iniciativave te reja ne mbeshtetje te zhvillimit te turizmit	500			500	
Shuma		500			500	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurim e	Operativ e	Transferi me
A.1	Mbeshtetja e iniciativave te reja ne mbeshtetje te zhvillimit te turizmit	1000			1000	
Shuma		1000			1000	
f) Periudha e zbatimit 2025,2026,2027		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:				
		Stafi i drejtorisë së Turizmit.				
		Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër				

Nr. 25	P.AC141..Q3.O1.A13 Përmirësimi i infrastrukturës dhe shërbimeve në plazhe dhe në destinacione të tjera turistike	Programi AC141: Mbështetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural
---------------	--	--

a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:
i. Situata

Turizmi ka njohur një rritje të konsiderueshme vitet e fundit dhe destinacionet turistike në territorin e bashkisë Shkodër janë vizituar nga një numër i lartë turistësh të huaj nga Evropa dhe më gjerë, të cilët kanë shijuar bukuritë resurseve të shumta natyrore, që nga bregdeti, zonën e liqenit, alpet por edhe burimet kulturore dhe historike të zonës. Një nga problemet më të mprehta të zhvillimit të turizmit në vendin tonë është infrastruktura lidhëse dhe infrastruktura e dobët në destinacion. Nevojitet që të investohet në infrastrukturën bazë ndihmëse për aksesimin e këtyre destinacioneve. Mundësimi i aksesit në destinacionet turistike, përmirësimi i shërbimeve në destinacion dhe nxitja e zhvillimit të infrastrukturës turistike është një nga prioritetet për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm. Duke parë fluksin e lartë të frekuentimit që ka plazhi i Velipojës propozohen ndërhyrje të lehta në infrastrukturën dhe shërbimet mbështetëse të cilat do të jenë në ndihmë të pushuesve në plazhet publike dhe në shëtitoren e Velipojës. Ndërtimi i shkallareve që lidhin banesat dhe hotelet me pedonalen e Velipojës dhe plazhin si dhe vendosja e pedanave që përmirësojnë aksesin në plazh do të jenë dy ndërhyrjet e planifikuara të cilat do të rrisin cilësinë e frekuentimit të këtij plazhi. Gjithashtu, Bashkia Shkodër për zonën e Velipojës, ka planifikuar rritjen e sipërfaqeve publike duke krijuar akses për të gjithë vizitorët që duan të shfrytëzojnë këto hapsira. Në kuadër të mirëfunksionimit të këtyre hapsirave dhe evidentimit sa më të mirë të tyre propozohet vendosja e tabelave informuese që orientojnë vizitorët drejt këtyre plazheve publike. Gjithashtu për të pasur sa më të qartë hapsirat e shfrytëzimit të plazheve midis publikut dhe privatit por edhe për të krijuar një mjedis sa më të këndshëm dhe të rregullt parashikohet edhe vendosja e piketave për plazhet publike. Rëra e Velipojës është një nga resurset natyrore më me vlerë të territorit dhe pastrimi i saj përpara fillimit të sezonit është me shumë rëndësi prandaj parashikohet marrja me qera e mjetit që realizon pastrimin e kësaj sipërfaqeje rënore.

ii. Synimi i projektit

